

Neni 1

Autoriteti

Këto rregulla hartohen në zbatim të nenit 69 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 9501 datë 03/04/2006 “Për ratifikimin e Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë”.

Neni 2

Objekti

1. Këto rregulla përcaktojnë procedurat dhe kërkesat për informacion, lidhur me aksesin në kohë të të dhënave të OSSH mbi konsumin e energjisë elektrike në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese.
2. Këto rregulla gjithashtu përcaktojnë në mënyrë të detajuar detyrimet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në lidhje me vënien në dispozicion të të dhënave që lidhen me konsumin e energjisë elektrike nga klientët fundorë dhe çështjeve të tjera të nevojshme për publikimin e tyre.

Neni 3

Aksesi i të dhënave

1. OSSH do të sigurojë për furnizuesit, si pjesë të Shërbimit të ofruar prej saj, aksesin në të dhënat e konsumit të energjisë elektrike nga Klientët.
2. Operatori/OSSH do të sigurojë këtë shërbim nëpërmjet një faqeje interneti të dedikuar, por edhe nëpërmjet çdo qendër të kujdesit të klientit, ku Furnizuesi paraqitet me kërkesë për të dhëna. Historiku i konsumit është në dispozicion përmes faqes së internetit apo nëpërmjet dokumentit të vënë në dispozicion nga Qendrat e Kujdesit të Klientit apo edhe çdo formë tjetër të dërgimit të të dhënave, përfshirë por pa u kufizuar, përmes mesazheve telefonike e forma të tjera të arritshme nga publiku.
3. Informacioni historik që përfshin konsumi vjetor për jo më pak se një periudhë që përfshin pesë vitet e fundit, është një e drejtë e garantuar për të gjithë furnizuesit nga legjislacioni. Për më tepër, të dhënat mbi baza mujore e informacionit sigurohen nga OSSH tek Furnizuesi.
4. OSSH i siguron furnizuesit edhe të dhënat e energjisë elektrike mbi baza orare për të gjithë klientët kur pajisjet e matjes e lejojnë një përlllogaritje të tillë.
5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të dorëzojë tek Furnizuesi të dhënat e kërkuara, sipas kësaj rregullore jo më vonë se 1 (një) ditë kalendarike pas marrjes së kërkesës nga një Furnizues. Format i kërkesës do jetë sipas Aneksit Nr. 1 të kësaj Rregulloreje.

Rregullat 'Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e Furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike'

6. Furnizuesi që kërkon të dhënat si më sipër, duhet që më parë të ketë nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti, nëpërmjet të cilës garanton përmbushjen e detyrimeve ligjore duke përfshirë, në veçanti, legjislacionin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 4

Detyrime te tjera

1. OSSH do të krijojë kode që përcaktojnë rregullat për përdorimin dhe hyrjen në të dhënat e përcaktuara sipas këtyre rregullave.
2. Furnizuesi nuk ka akses të drejt përdrejtë në programet e aksesit, por do të ketë akses nëpërmjet fjalëkalimit personal në të dhënat e konsumit të energjisë elektrike nga OSSH duke përdorur një portal të përbashkët për të gjithë furnizuesit.
3. Në çdo rast, ky portal do të sigurojë identifikimin individual elektronik të furnizuesit që akseson të dhënat, të cilit i përkon një kod unik që do të gjenerohet për çdo furnizues të regjistruar, e që ka një kontratë dhe marrëveshje konfidencialiteti me OSSH.
4. Për të gjitha rastet kur kërkohet nga Furnizuesi, OSSH do të ofrojë të dhëna sipas formatit mbi baza orare, mujore, tremujore dhe vjetore.
5. Informacioni mbi këto të dhëna, përditësohet jo më shumë se pesë ditë (kalendarike) pas ditës së konsumit /të fundit të regjistruar, kur paisjet e matjes lejojnë matjet orare
6. Në çdo rast tjetër, përditësimi i të dhënave do t'i korrespondojë muajit të fundit të regjistruar me matje.

Neni 5

Interpretimi

1. Në rast se një çështje nuk është trajtuar në këtë Rregullore, ERE do të vendosë rast pas rasti dhe do të nxjerrë udhëzimet sipas kërkesave përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. **Termat dhe përkufizimet e përdorura në të do të kenë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"**

Neni 6

Amendime të rregullores

Këto rregulla janë ë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE, si dhe në përputhje me rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Rregullat "Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e Furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike"

Neni 7

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore "Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" hyn në fuqi, jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i këtyre Rregullave nga ERE.
2. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave, në çdo rast OSSH do të sigurojë këtë akses te Furnizesit sipas formave të tjera të parashikuara në këte rregullore.

Rregullat ‘Për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e Furnizuesve ndaj të dhënave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike’

ANEKSI
FORMATI I TË DHËNAVE

| | |
|---|--|
| NR.KODI UNIK I KËRKESËS | |
| KËRKUESI | |
| DATA E RREGJISTRIMIT TË KËRKESËS | |
| KODI I KLIENTIT OBJEKT I KËRKESËS NGA FURNIZUESI | |
| TË DHËNA MBI KONSUMIN VJETOR/DITOR /MUJOR/ORAR SIPAS KËRKESËS | |
| NËSE NUK SPECIFIKOHET NË KËRKESË, TË DHËNAT DO TË PËRFSHIJNË KONSUMIN VJETOR TË 5 VITEVE TË FUNDIT | |
| AFATI I TRAJTIMIT | |
| DETYRIMI PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE SIPAS KËRKESAVE TË LIGJIT “PËR MBROJTEN E TË DHËNAVE PERSONALE” | |